



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-3065/14
Nr. f. t. au Broj stranica 02	Data Datum 03-09-2014
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.09.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3305/13, për z. Rexhep Selimi, Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Rexhep Selimi, Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Selimi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme, si Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe si person i autorizuar në biznesin privat D.P.H "Restoran 506".

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është njoftuar për situatën në të cilën ndodhet, të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Selimi ka deklaruar se biznesi është pasiv, nuk është funksional, por vetëm ka mbetë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Zyrtari i lartë z. Selimi nuk është duke ushtruar pozitën si person i autorizuar në biznes privat, kjo është vërtetuar me shkresat zyrtare të dërguara në Agjenci, të lëshuara nga Administrata Tatimore e Kosovës (DPKI.02-577/14)(DPKI.03-1178/14)(DPKI.03-2077/14), në të cilën vërtetohet se biznesi është pasiv, nuk është funksional dhe është në procedurë të mbylljes së biznesit privat.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

